



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË PANELIT ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA PËR VITIN 2023

Prishtinë, qershor 2024

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të PZAP kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Drejtor i Sekretariatit të PZAP është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Drejtor i Sekretariatit të PZAP është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryesues i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që

cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKAsë, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Sa i përket menaxhimit financiar duhet t'i kushtohet vëmendje e shtuar regjistrimit dhe zhvlerësimit të pasurive si dhe kategorizimit të pozitive sipas ligjit të pagave në sektorin publik. Ndërsa në aspektin e pajtueshmërisë të veprohet me kujdes në caktimin e anëtarëve të komisioneve që mund të kenë konflikt interesi.

Ky raport ka rezultuar me tre (3) rekomandime, prej tyre dy (2) rekomandime të reja dhe një (1) rekomandim i përsëritur. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe shtesa mëditje krahas buxhetit fillestar është rritur për 16,296€, me vendimet e Qeverisë së Kosovës me Nr.09/169 te datës 27.10.2023.

Çështja A1 - Mangësi në kategorizimin sipas ligjit të pagave për anëtarët e PZAP-së

Gjetja Neni 12, paragrafi 2, i Ligjit nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, përcakton se: Në rastin kur edhe kryetari i organit drejtues është me kohë të pjesshme, atëherë shpërblimi i anëtarëve të organit drejtues, bëhet në masën tridhjetë për qind (30%) për kryetarin dhe njëzet për qind (20%) për anëtarët/ët, të pagës bazë së zyrtarit kryesor administrativ të institucionit.

Ne kemi vërejtur se shtesa/shpërblimi për kryesuesin dhe anëtarët e panelit të PZAP-së nuk ishte në pajtueshmëri me kërkesat e ligjit për pagat e sektorit publik. Në vend të masës prej 30% për kryesuesin dhe 20% për anëtarët, mbi pagën bazë të zyrtarit kryesor administrative në PZAP, ishte aplikuar masa prej 50% të pagës bazë të përcaktuar për organet drejtuese kolegjiale.

Kjo ka ndodh si rezultat i mungesës së kontrolleve të brendshme të zyrtarëve kompetent në procesimin e shtesës/shpërblimit për anëtarët e organeve drejtuese për kohë të pjesshme.

Ndikimi Mungesa e kontrolleve adekuate dhe mos zbatimi i drejtë i kërkesave ligjore në procesimin e shtesës/ shpërblimeve për kryesuesin dhe anëtarët e panelit të PZAP-sëit ndikon në kompenzimin joadekuat sipas ligjit të pagave.

Rekomandimi A1 Sekretari i PZAP-së duhet të sigurojë se shtesa/shpërblimi i kryesuesit dhe anëtarëve të panelit të PZAP-itsë të kategorizohet në përputhje me ligjin e pagave në sektorin publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.1.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale në vitin 2023 ishte 9,000€, prej tyre ishin shpenzuar 4,376€, për zhvillimin dhe dizajnimin e webfaqes zyrtare të PZAP-së.

Çështja A2 - Ndarje jo e drejtë e detyrave

Gjetja

Neni 75.3, pika 7 të rregullores nr.01/2022 për Prokurimin Publik, përcakton se: "Një anëtar i komisionit të vlerësimit nuk mund të emërohet si menaxher i kontratës, mirëpo në rast të ri-vlerësimit, anëtarët e komisionit të kaluar të vlerësimit mund të shërbejnë si menaxher të kontratës".

Në projektin "Dizajnimi i web faqes zyrtare dhe sistemit për menaxhimin e ankesave dhe parashtresave", kemi vërejtur se zyrtari i cili ishte anëtar i komisionit të vlerësimit, i njëjti ishte caktuar edhe menaxher i kontratës.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së mjaftueshme të stafit dhe moskujdesit në ndarjen e detyrave.

Ndikimi

Ndarja jo e drejtë e detyrave është në kundërshtim me parimet e prokurimit publik dhe mund të ndikojë në konflikt interesi gjatë përmbushjes së detyrave të përcaktuara.

Rekomandimi A2

Sekretari i PZAP-së duhet të sigurojë se para se të merret vendimi për emërim të komisioneve dhe menaxherëve të kontratës, të merren parasysh parimet për ndarjen e detyrave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.3 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Pasuria kapitale neto e prezantuar në pasqyrat financiare është 10,431€, ndërsa ajo jo kapitale 11,519€. Zhvlerësimi i pasurive në sistemin e-pasuria dhe regjistrimi i pasurisë jo kapitale dhe kapitale mbetet sfidë për PZAP-në, ku si rrjedhojë janë identifikuar mangësitë e mëposhtme.

Çështja B1 - Prezantim jo i drejtë i pasurive në PFV

Gjetja

Sipas nenit 22, paragrafet 1,2 dhe 3 të rreg.02/2013 - për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore: 'Zhvlerësimi i pasurive bëhet sipas metodës drejtvizore. Pasuritë duhet të vlerësohen duke marrë parasysh zhvlerësimin që është grumbulluar nga momenti i blerjes së pasurisë. Zhvlerësimi llogaritet në baza mujore, pasuria nuk zhvlerësohet për muajin e blerjes dhe të gjitha pasuritë jo financiare kapitale dhe jo kapitale do t'i nënshtrohen normave të zhvlerësimit. Më tutje, neni 6.3 i rregullores së njëjtë specifikon se "Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria".

Gjatë testimeve të pasurive kapitale dhe jo kapitale kemi vërejtur mangësitë si në vijim:

- Pasuritë jo-kapitale nën 1,000€ në PFV, janë mbivlerësuar për 8,671€, si rezultat i mos aplikimit të zhvlerësimit, si dhe është nënvlerësuar për 865€ si rezultat i mosregjistrimit në regjistrat kontabël pasurinë "Furnizimi për zyre- me nxemse";
- Pasuritë kapitale mbi 1,000€ në PFV, janë nënvlerësuar për 4,736€, si rezultat i mos regjistrimit të pasurisë "Dizajnimi i webfaqes zyrtare".

Zyrtari i PZAP-së, në muajin prill 2024 në bashkëpunim me zyrtarët përgjegjës të MPB-së ka aplikuar zhvlerësimin e këtyre pasurive në sistemin e-pasuria. Kjo do të vlerësohet nga ekipi i auditimit për vitin 2024.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së kontrolleve në fushën e pasurisë të cilat nuk kanë arritur me i identifikuar dhe parandaluar devijimet e tilla.

Ndikimi

Mos regjistrimi i blerjeve dhe mos aplikimi i zhvlerësimit të pasurisë ka ndikuar në mbivlerësim të vlerës së përgjithshme të pasurisë në PFV.

Rekomandimi B1

Sekretari i PZAP-së duhet të sigurojë që para përgatitjes së PFV-ve, aplikohet zhvlerësimi për të gjitha pasuritë, si dhe të gjitha pasuritë e blera regjistrohen në planin kontabël, në mënyrë që prezantimi i

tyre në PFV për vitin 2024 të jetë i plotë dhe i saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Burimet e fondeve	207,742	224,038	195,766	181,932	224,899
Grante Qeveritare – Buxheti	207,742	224,038	195,766	181,932	224,899

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 16,296€. Ky ndryshim ishte me vendim të Qeverisë si rezultat i hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik për mbulimin e mungesës së mjeteve buxhetore në kategorinë e Pagave dhe Shtesave.

Në vitin 2023 PZAP ka shpenzuar 87% të buxhetit përfundimtar ose 195,766€, që është përqindje pothuajse e njëjtë e realizimit sikurse në vitin 2022.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	207,742	224,038	195,766	181,932	224,899
Pagat dhe mëditjet	140,922	157,218	157,218	135,331	147,577
Mallrat dhe shërbimet	50,000	50,000	34,030	31,484	77,010
Komunalitë	7,820	7,820	142	126	312
Investimet Kapitale	9,000	9,000	4,376	14,990	0

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore, janë dhënë si në vijim:

·Buxheti final për paga dhe mëditje krahas buxhetit fillestar është rritur për 16,296€, me vendimet e Qeverisë. Këto ndryshime janë bërë për arsye të hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik për mbulimin e mungesës së mjeteve


buxhetore për këtë kategori. Shpenzimet në këtë kategori ishin 100% e buxhetit final.
 ·Buxheti final për mallra dhe shërbime/komunali krahas buxhetit fillestar nuk kishte ndryshime.

Shpenzimet në këtë kategori ishin 59% e buxhetit final.

·Buxheti final për investime kapitale krahas buxhetit fillestar nuk kishte ndryshime.

Shpenzimet në këtë kategori ishin 49% e buxhetit final.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat e realizuara nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në 2023 ishin në vlerë 6,514€. Ato kanë të bëjnë me gjambat ndaj subjekteve politike gjatë proceseve zgjedhore. Krahasuar më vitin paraprak kemi ulje të të hyrave për 32,886€ apo 83%. Kjo ulje ka reflektua pasi që në vitin 2023 nuk ka pas zgjedhje dhe nuk janë shqiptuar gjoba.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet
Totali i të hyrave	0	0	6,514	39,400	237,300
Të hyrat jo tatimore	0	0	6,514	39,400	237,300

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2022 të Panelit Zgjedhor Për Ankesa dhe Parashtresa ka rezultuar me një (1) rekomandim. PZAP nuk kishte dorëzuar një plan veprimi në ZKA.

Deri në fund të auditimit për vitin 2023, kemi vërejtur se rekomandimi nuk ishte adresuar.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimit dhe mënyrën se si është trajtuar, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pasuritë	Kryetari i PZAP duhet të sigurojë që për të gjitha pasuritë janë aplikuar normat e zhvlerësimit, në mënyrë që prezantimi i tyre në PFV të jetë i plotë dhe i saktë	Edhe gjatë vitit 2023 ishte gjendja e njëjtë sa i përket mos prezantimit të saktë të vlerës së pasurive në PFV.	Nuk ka filluar zbatimi

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm




Blerina Krasniqi, Drejtore e Auditimit



Ramadan Gashi, Udhëheqës i ekipit



Selvete Foniqi, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Mangësi në kategorizimin sipas ligjit të pagave për anëtarët e PZAP-së	<p>PZAP-ja, nuk pajtohet me Gjetjet dhe Rekomandimin e Ekipit të Auditimit për sa i përket: “Çështja 1 – Mangësi në kategorizimin sipas ligjit të pagave për anëtarët e PZAP-së më në detaje referuar Draft Raportit”, për arsytet si në vijim:</p> <p>1. Kjo gjetje si “Çështja 1” ndaj PZAP-së është e gabuar, nga se PZAP-ja, nuk ka asnjë kompetencë ligjore për kategorizimin e zyrtareve publik sipas ligjit për pagat e zyrtareve publik gjegjësisht rekomandimi është jashtë kompetencave të PZAP-së.</p> <p>Arsyetim: Ligji Nr. 08/L-196, për Pagat e zyrtareve publik me rastin e hyrjes në fuqi, ka bërë kategorizime sipas shtojcave që janë paraparë. Rrjedhimisht për tu definuar kategorizimet e sakta lidhur me çdo zyrtar publik në kuadër të institucioneve publike, është dërguar pozita dhe funksioni i çdo zyrtari në kuadër të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publik.</p> <p>Duke qenë se Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin Nr. 04/128 të datës.16.02.2023, ka Miratuar Ekuivalencën e pagave, e cila ekuivalencë ishte propozuar nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publik dhe Thesari, ka rezultuar edhe ky vendim, rrjedhimisht gjetja e Auditorit nuk mund t'i referohet PZAP-së, sa i përket “Çështjes 1”, duke qenë</p>	<p>Në komentin e juaj nuk keni ofruar asnjë dëshmi që vërtetojnë të kundërtën, dhe si e tillë gjetja mbetet e pa ndryshuar.</p> <p>Keni përshkruar mënyrën e qasjes se juaj mbi ligjin e pagave, se si ka ardhur deri tek hartimi tij dhe emalat e dërguar nga zyrtarët tuaj komisionit përkatës, që për çështjen janë jo-relevante, ngase ne ju kemi referuar ligjit për paga dhe bazës ligjore për kompensimin e anëtarëve e PZAP-it, por jo për zyrtarët tjerët. Për me tepër, gjatë komentimit tuaj askund nuk e keni atakuar gjetjen as në aspekt formal dhe as në aspekt të dëshmive që vërtetojnë të kundërtën.</p> <p>Poashtu theksimi se kjo çështje është jashtë kompetencave të PZAP-it, por nuk ju keni referuar bazës ligjore që ju bënë jo kompetent apo ju përjashton për të menaxhuar me institucionin që udhëhiqeni. Ajo çfarë është kundërthënëse se për këtë çështje jeni jo kompetent ndërsa për dy çështje tjera keni kompetencë për të adresuar. Për më tepër, LIGJI NR. 08/L-228 PËR ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME NË REPUBLIKËN E KOSOVËS, Neni 122- Zgjedhja, mandati dhe përgjegjësitë e drejtorit të Sekretariatit, përcakton qartë detyrat dhe përgjegjësitë që ju keni karshi PZAP-it.</p> <p>Ju në vazhdimësi keni bërë përpjekje për të adresuar këtë çështje që i bie që është</p>

	<p>se gjetjet nuk mund t'i atribuohen një organi publik siç është PZAP-ja, që as nuk kishte kompetencë për kategorizim dhe as nuk ka marr asnjë vendim për kategorizim.</p> <p>Përkundër se Qeveria ka miratuar ekuivalencën e pagave për Anëtarët e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa sipas vendimit, nr. 04/128, i datës 16.02.2023, e që Kryesuesi i PZAP-së ishte kategorizuar në Klasa 11 Koeficienti 13, ndërsa anëtarët e PZAP-së, ishin kategorizuar në klasën 13 koeficienti 12.5, PZAP-ja, me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së këtij kategorizimi që ishte bërë nga ana e Qeverisë dhe jo nga ana e PZAP-së, si institucion kemi ndërmarr veprime në drejtim të institucionit të DMZP/MPB dhe atë:</p> <p>a) Me datën 27.12.2022, zyrtarja e DMZP-se/MPB Minire Gjoka, përmes emailit ka kërkuar nga zyrtarja Valbona Millaku të dhënat për klasifikimin e vendeve të punës për PZAP.</p> <p>Me datën 05.01.2023 zyrtarja Valbona Millaku, zyrtaren e DMZP-se/MPB Minire Gjoka përmes emailit e ka njoftuar dhe i ka dorëzuar të dhënat e kërkuara për procesin e klasifikimit të vendeve të punës, dhe i ka bashkangjitur tabelën e plotësuar për institucionin e PZAP-it, si dhe Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimit të vendeve të punës në PZAP.</p> <p>Me datën 21.01.2023 zyrtarja Valbona Millaku, zyrtaren e DMZP-se/MPB Minire Gjoka përmes emailit përsëri e ka njoftuar dhe i ka dorëzuar të dhënat lidhur me Procesi i</p>	<p>përgjegjësi e juaj për të zbatuar ligjin e aplikueshëm në fuqi. Në fund të komentit keni theksuar se duhet të merret parasysh ligji për zgjedhje, ne nuk kemi adresuar mënyrës së zgjedhjes së kryesuesit dhe anëtarëve të PZAP-i që definohet me këtë ligj, por ne ju kemi referuar ligjit për paga në sektorin publik dhe mënyrës së pagese së tyre. Po ashtu, keni theksuar që kjo çështje të adresohet tek Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe jo PZAP-it. Ju rikujtoj se ne objektiv të auditimit kemi pasur PVF-të e PZAP-së për vitin 2023, e jo Këshillit Gjyqësor.</p>
--	---	--

	<p>klasifikimit të vendeve të punës për PZAP – Aktemrimet e zyrtareve publik, vendimet e emërimit të anëtarëve të PZAP-it dhe Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimit të vendeve të punës në PZAP.</p> <p>b) Kërkesë për dhënien e opinionit ligjor lidhur me klasifikimin e nivelit të pagës për kryesuesin dhe anëtarët e PZAP-it, me Nr.prot.16/2023, e datës 10.03.2023, përmes emailit i është dërguar Bislim Bislim, Drejtor i DMZP-së MPB, dhe e njëjta kërkesë i është ridërguar Agim Fejzullahut, DMZP-së MPB përmes emailit me datë 28 Prill 2023.</p> <p>c) Në raport me kërkesën me Nr.prot.16/2023, e datës 10.03.2023, për dhënien e opinionit ligjor lidhur me klasifikimin e nivelit të pagës për kryesuesin dhe anëtarët e PZAP-it, PZAP – ja, ka pranuar Përgjigjen zyrtare nga znj. Shqipe Abdullahu si zyrtare për Politika të Personelit, e cila përmes emailit ka njoftuar PZAP-në, se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë /MPB sqaron se me vendimin nr. 04/128 të datës 16.02.2023, është miratuar ekuivalenca nga Qeveria e Republikës së Kosovës, pas propozimit të Komisionit përkatës DMZP/MPB dhe Thesari/MFPT, dhe në bazë të kësaj mund të konfirmojmë se përcaktimi i klasave të pagave për anëtarët e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, është si vijon: për Pozitën Kryetar i komisionit të PZAP-it, emërtimi sipas Ligjit të pagave Kryetarja/i e/i Organit Kolegjial, Klasa e pagës A11, koeficienti 13, për pozitën Anëtar i komisionit të PZAP-it, emërtimi</p>	
--	---	--

	<p>sipas Ligjit të pagave Anëtar/e i/e Organit Kolegjial Klasa e pagës A13 koeficienti 12.5, ndërsa ka theksuar se:</p> <p>“Departamenti për Menaxhimin e zyrtareve publik ju udhëzon që sa i përket çështjeve të ekzekutimit të pagave për anëtarët e PZAP-së, luteni që t’i drejtoheni Thesarit/ MFPT si institucion përgjegjës, kurse sa i përket klasave tjera për korrigjimin e klasave do të merrni përgjigje së shpejti nga DMZP” .</p> <p>Prandaj për këto tri arsye konsiderojmë se e gjetura në draft raportin e ZKA-së, përbën të gjetur të gabueshme në raport me Entitetin e Auditimit (PZAP – in), për faktin se kategorizimi nuk i takonte PZAP-së si kompetencë, kategorizimi ishte bërë sipas propozimit të dy institucioneve DMZP-së dhe Thesarit që ishte miratuar në Qeveri me vendimin nr.04/128 i datës 16.02.2023, dhe se veprimet e PZAP-së, për rishikimin e kategorizimit ishin përpjekje të vazhdueshme përkundër se nuk i takonte si kompetencë.</p> <p>Lidhur me rekomandimin: “A1, Sekretari i PZAP-së duhet të sigurojë se shtesa/shpërblimi i kryesuesit dhe anëtarëve të panelit të PZAP-së të kategorizohet në përputhje me ligjin e pagave në sektorin publik”. Ne si PZAP vlerësojmë se para se të iplej ky rekomandim është dashur të merret për bazë Ligji Për Zgjedhjet e përgjithshme dhe Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, Nr. KO 79/2023 i datës 23.01.2024.</p> <p>Nga këto arsye vlerësojmë se rekomandimi do duhej të ishte ndryshe, përkatësisht çështja të trajtohet nga Këshilli Gjyqësor i</p>	
--	---	--

	<p>Kosovës, duke qenë se PZAP-ja është pjesë përbërëse e Institucioneve të Drejtësisë si Kategori e Institucioneve të Pavarura Kushtetuese.</p>	
--	---	--



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
 KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
 PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
 IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa për vitin 2023 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- 1. **pajtohem pjesërisht/** me gjetjet dhe rekomandimet draft raportit. Komentet ju kemi dërguar dje me shkresën e protokolluar nga PZAP-i Nr. 38 date 11.06.2024 të emëruar: Shtojca I - Letër Konfirmim / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit, të cilën ju kemi dërguar në formë fizike dhe elektronike përmes postes private për shkak të problemeve me internet zyrtar.
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Mulë Desku

U.D Drejtor i Sekretariatit të PZAP-it

Data: 12.06.2024, Prishtinë



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri.

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.